



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

---

Në bazë të nenit 3 dhe 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve në Gjykata, për Praktikant Vullnetarë (pa pagesë), për kohë të caktuar prej një (1) viti, Gjykata Themelore në Prizren, shpall:

**K O N K U R S**  
**Nr.01/2019**

**Titulli i vendit të punës:** Praktikant Vullnetar (pa pagesë)

- |   |                  |
|---|------------------|
| <b>1.Gjykata Themelore në Prizren-----</b>                  | <b>30 pozita</b> |
| <b>2.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë-----</b> | <b>20 pozita</b> |
| <b>3.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash-----</b>  | <b>10 pozita</b> |

**Nënpunësi mbikëqyrës:** Administrator i Gjykatës-Ndihmës Administratori.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Me afat të caktuar në kohëzgjatje prej një (1) viti, pa pagesë.

**Vendi:** Gjykata Themelore në Prizren dhe degët e saja në Suharekë dhe Dragash

**Përshkrimi i detyrave të punës:**

**Detyrat e Praktikantit:** Ndihmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

**Detyrat kryesore:** Vepron në mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të Kryetarit të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e Administratorit të Gjykatës.

- ❖ Ndihmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi.
- ❖ Ndihmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë në futjen e lëndëve në dosje.
- ❖ Ndihmon në punën e zyrave të ndryshme në gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet e të tjera.
- ❖ Kryen edhe pune tjera sipas nevojës.

**Kualifikimet:**

Diplomë e Fakultetit Juridik, programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master.

- Njohuri të procedurave gjyqësore.
- Aftësi për kryerjen e procedurave gjyqësore (juridike).
- Njohuri të mjaftueshme ligjore.
- Aftësi të shkëlqyeshme për përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

- VËREJTJE

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe nëpunës civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil (Ligji Nr.03/L-149, dhe Rregullores për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores për procedurën e rekrutimit të Praktikantëve (Rregullorja Nr. 02/2010).
- Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar.

**Konkursi është publikuar më datën 11.01.2019 dhe mbyllet më datën 25.01.2019.**

**Aplikacionet mund të tërhiqen dhe dorëzohen në Gjykatën Themelore në Prizren ose në degët e saj në Suharekë dhe Dragash.**

[Shkarko Aplikacionin](#)

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha personat e gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komuniteti jo shumicë kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e Shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës .

Pas skadimit të afatit të konkursit, aplikacionet nuk do të pranohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçar. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe të lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të plotësohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron.

Aplikacionit duhet të i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë:

- -Kopja e diplomës për shkollën e kryer
- -Specializimet e ndryshme profesionale
- -Certifikatë të tjera, vërtetime, rekomandime etj.
- -Certifikatë që nuk është nën hetime

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, aplikacionet nuk do të shqyrtohen.

-Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin mbrapa.